



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 699/1 Prot.

Tiranë, më 29.02 2024

VENDIM

Nr. 15 dt. 29.02 2024

“PËR

MIRATIMIN E PËRCJELLJES SË DOKUMENTACIONIT TË DR. ALTIN MARTIRI
PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR” PRANË KPPA”

Në zbatim të nenit 38, 60 pika 3, 79 pika 7 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, kreut IV pika 1 dhe 2 të V.K.M-së nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, nenit 20, 27 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së UST-së, nenit 4, 7 dhe 13 të Rregullores së Veprimtarisë së Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së, mbështetur në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr.580/5 Prot., datë 23.2.2024 “Përcjellje dokumentacioni për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar të Dr. Altin Martiri”; Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.02.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë përcjelljen e dokumentacionit të Dr. Altin Martiri për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”, pranë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së.
2. Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik të vijojë me procedurat sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, Njësisë Kryesore Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Dixhitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

